

URDHËR
Nr. 51, datë 14.1.2026

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave znj. Erlira Gjikondi, Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Legjislacionit, për sa vijon:

- Për të nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridik privat), si dhe ato të drejtuar strukturave të varësisë së ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, përgjegjësi i Sektorit të Hartimit të Legjislacionit, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të përgjegjësit të Sektorit të Hartimit të Legjislacionit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurës Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Urdhri nr. 2164, datë 21.11.2024, i drejtorit të përgjithshëm “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor dhe znj. Erlira Gjikondi, dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli